LIGJ
Nr.7541, datë 18.12.1991

PËR AVOKATINË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Avokatia në Republikën e Shqipërisë ka për detyrë t'u japë ndihmë juridike shtetasve shqiptarë e të huaj, personave juridikë shqiptarë e të huaj, organeve, institucioneve shtetërore dhe organizatave shoqërore.

Neni 2

Ndihma juridike jepet:
a) me këshillime për çështje ligjore;
b) me përgatitje të kërkesëpadive ose të kërkesave për ndjekje penale;
c) me përgatjtje të kërkesave ankimore kundër vendimeve gjyqësore, të hetuesisë, të arbirtrazhit, të organeve të administratës shtetërore etj.;
ç) me përgatitje të ankesave e të kërkesave të shtetasve;
d) me përpilimin e akteve që vërtetohen nga noteri;
dh) me pjesëmarrjen si mbrojtës në hetuesi dhe në gjykimin e çështjeve penale;
e) me përfaqësimin e pjesëmarrësve në proces në gjykimin e çështjeve civile, në arbitrazh dhe në organet e tjera shtetërore, për çështje civile e administrative;
ë) në raste të tjera të parashikuara në ligj.

Neni 3

Për të mbikëqyrur veprimtarinë e avokatisë, krijohet Këshilli Mbikëqyrës i përbërë prej drejtorit ose kryetarit të degës së avokatisë në Ministrinë e Drejtësisë dhe prej 6 avokatëve të zgjedhur nga mbledhja e përgjithshme e avokatëve.
Këshilli Mbikëqyrës i avokatëve është i pavarur në ushtrimin e veprimtarisë së tij.

Neni 4

Këshilli Mbikëqyrës ka këto kompetenca:
a) Jep lejen për ushtrimin e profesionit të avokatit, kur juristi plotëson kushtet e parashikuara në këtë ligj.
b) Vendos masat administrative dhe disiplinore për avokatët që shkelin rregullat e ushtrimit të profesionit të avokatit.

KREU II
MËNYRA E USHTRIMIT TË PROFESIONIT
TË AVOKATIT DHE TË DREJTAT E DETYRAT E TIJ

Neni 5

Avokati e ushtron profesionin:
a) si individ;
b) me ortakëri ose me kolektiva të avokatëve.

Neni 6

Avokati e ushtron veprimtarinë në rrethin ku ka qendrën e tij, si dhe në organet ku bëhet shqyrtimi në shkallë të dytë i çështjeve.

Me kërkesën e të interesuarve avokati mund të marrë përsipër çështje edhe në rrethe të tjera të vendit ose jashtë shtetit.

Avokati mund të heqë dorë nga përfaqësimi ose mbrojtja e filluar, duke kthyer shpërblimin e marrë.

Neni 7

Avokati, me cilësinë e tij si përfaqësues ose si mbrojtës, ka të drejtë të kërkojë nga organet shtetërore ose personat e tjerë juridikë njoftime e dokumente, të cilat kanë të bëjnë me çështjen ose personin që përkatësisht përfaqëson a mbron. Organet shtetërore dhe personat e tjerë juridikë detyrohen të plotësojnë kërkesat e avokatit.

Neni 8

Avokati përdor të gjitha mjetet e ligjshme për mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të shtetasve shqiptarë ose të huaj, si dhe të personave juridikë shqiptarë a të huaj.

Neni 9

Avokati nuk mund të marrë përsipër çështje, kur me hetuesin, prokurorin ose gjyqtarin që shqyrton çështjen, është gjini apo krushqi e afërt. Gjithashtu nuk mund të marrë përsipër një çështje, në të cilën ka marrë pjesë si hetues, prokuror, gjyqtar, ekspert ose dëshmitar.

Avokatit i ndalohet të japë ndihmë juridike ose të përfaqësojë në gjyq njërën palë, kur më parë i ka dhënë këtë ndihmë ose ka përfaqësuar palën tjetër në këtë çështje.

Neni 10

Avokati nuk detyrohet të bëjë kallëzim në organet kompetente dhe nuk mund të pyetet si dëshmitarë për rrethana që ka mësuar gjatë ushtrimit të profesionit si avokat. Atij i ndalohet të përhapë të dhëna që i ka mësuar gjatë kryerjes së detyrës së tij për dhënien e ndihmës juridike.

Neni 11

Avokati ka të drejtë të takohet vetëm për vetëm me të pandehurin e arrestuar si dhe sa herë e kërkon i pandehuri, të njihet me gjithë materialin e dosjes hetimore në përfundim të hetimeve, t'i drejojë pyetje të pandehurit ose dëshmitarit në prani të hetuesit dhe të marrë pjesë në kryerjen e veprimeve hetimore. Ai ka të drejtë të bëjë vërejtje në procesverbalin e veprimit hetimor, kur ka marrë pjesë, dhe ta nënshkruajë atë.

KREU III
E DREJTA E USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË AVOKATIT

Neni 12

Leja për ushtrimin e profesionit si avokat jepet nga Këshilli Mbikëqyrës për shtetasit shqiptarë

që kanë mbaruar arsimin e lartë juridik dhe nuk janë dënuar për vepra penale.

Profesionin e avokatit e ushtrojnë edhe pedagogët e fakultetit të Drejtësisë. Këtë të drejtë gjithashtu, e gëzojnë edhe juristët me tituj e grada shkencore, përveç rasteve kur ka pengesa ligjore.

Neni 13

Ndalohet të ushtrojnë profesionin e avokatit juristët që kryejnë detyra shtetërore me pagë të përhershme, përveç atyre që aktivizohen në bazë të nenit 12, paragrfi i dytë i këtij ligji.

Neni 14

Juristët që ushtrojnë profesionin e avokatit duhet të jenë të regjistruar në regjistrin e avokatëve në Ministrinë e Drejtësisë.

Neni 15

Avokati ka të drejtë të ketë asistencë për përgatitjen e tyre si avokatë, si dhe personel administrativ.

Asistentët zgjidhen nga vetë avokati dhe regjistrohen në regjistrin e asistentëve në Ministrinë e Drejtësisë.

KREU IV
SHPËRBLIMI I PUNËS SË AVOKATIT

Neni 16

Avokati ka të drejtë të marrë nga i interesuari shpenzimet që ka bërë për kryerjen e veprimeve avokatore, si dhe shpërblimin për ndihmën juridike që jepet sipas nenit 2 të këtij ligji.

Shpërblimi e shlyerja e shpenzimeve bëhet sipas marrëveshjes ndërmjet avokatit dhe të interesuarit, pa kaluar tarifat e caktuara në rregulloren e miratuar nga ministri i Drejtësisë dhe ai i Financave.

Neni 17

Shpërblimi në çdo rast do të pasqyrohet në dokumentin që nënshkruhet nga të interesuarit dhe avokati, kopja e të cilit bashkëlidhet me dosjen hetimore ose gjyqësore. Për shpërblimet e tjera avokatore kopja e dokumentit mbahet nga avokati.

Neni 18

Personat juridikë e fizikë shqiptarë ose të huaj mund të lidhin kontratë edhe me shpërblim fiks për punën e avokatit.

Neni 19

Avokati dhe asistenti mbajnë librin për punën që kryejnë ku pasqyrohen edhe pagesa që bëjnë të interesuarit.

Mosplotësimi i rregullt i librit të të ardhurave formon shkelje disiplinore.

Neni 20

Avokatët dhe punonjësit e tjerë të avokatisë gëzojnë të drejtën e sigurimeve shoqërore, sipas rregullave të caktuara në ligj për punonjësit e tjerë.

KREU V
MASAT NDËSHKIMORE

Neni 21

Avokatët dhe asistentët kanë përgjegjësi disiplinore sidomos kur:

a) avokati ka marrë lejen për ushtrimin e profesionit të avokatit me dokumente të falsifikuara;

b) bën veprime të palejueshme dhe ndërhyrje haptazi të padrejta në organet shtetërore;

c) merr shpërblim më tepër se sa është përcaktuar në tarifa;

ç) nuk mban në rregull librin e punës të avokatit dhe të shpërblimeve që merr nga të interesuarit;

d) gjatë kohës që është ndaluar të ushtrojë profesionin e avokatit, kryen veprime avokatore;

dh) nuk shënon në aktet që harton, shpërblimin e marrë.

Neni 22

Ndaj avokatit ose asistentit Këshilli Mbikëqyrës, pasi vërteton shkeljet në kryerjen e detyrës, merr këto masa:

a) gjobë nga 1000 deri në 5000 lekë;

b) heqja e të drejtës së ushtrimit të profesionit të avokatit gjer në 5 vjet.

Neni 23

Masat ndaj avokatëve jepen brenda 1 muaji nga dita e zbulimit të shkeljes disiplinore dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita e kryerjes së saj, pasi dëgjohet më parë avokati nga Këshilli Mbikëqyrës.

Kur ai nuk paraqitet, shqyrtimi bëhet në mungesë të tij.

KREU VI
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 24

Ministria e Drejtësisë kujdeset dhe drejton punën për kualifikimin e avokatëve.

Për zbatimin e këtij ligji ministri i Drejtësisë nxjerr rregulloren përkatëse.

Neni 25

Çdo avokat ka vulën e tij në formë katërkëndëshi, ku shënohet titulli "avokat", gradat e titujt shkencorë, emri e mbiemri dhe qendra administrative ku ai ushtron veprimtarinë e tij.

Neni 26

Ligji nr.7382, datë 8.5.1990 "Për avokatinë në Republikën e Shqipërisë", shfuqizohet.

Neni 27

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.102, datë 25.12.1991 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ramiz Alia.